



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE**

SEKRETARIA TEKNIKE

DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE GJIROKASTËR



RELACION

**PROJEKT RESTAURIMI MANASTIRI I KRYEENGJËJVE NË DERVICIAN
GJIROKASTËR**

GJIROKASTËR 2026



Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastrë, Shqipëri. Tel: +355 84 26 9001

E-mail: drtkgjirokastr@meki.gov.al



TABELA PËRMBLEDHËSE

1.	Hyrje.....	4
2.	Objektivat.....	4
3.	ANALIZA HISTORIKE	5
3.1	Zhvillimi historic I Manastireve.....	5
3.2	Vendodhja	6
3.3	Morfologjia dhe Organizimi funksional	6
3.4	Fazat Ndërtimore.....	8
3.5	Ndërhyrjet ndër vite	9
4.	GJENDJA EKZISTUESE	12
4.1	Gjendja stukturore e muraturës.....	12
5.	PROPOZIM.....	15
5.1	Konsolidimi strukturor I muraturave prej guri (me dy parete dhe mbushje në mes me teknikën e injektimit).....	15
5.2	Konsolidimi dhe rindërtimi pjesor i muraturës me teknikën ekzistuese.....	16
5.3	Rindërtimi i çatisë së konakut	16

TABELA E FIGURAVE

Figure 1. Manastiri i Dervicianit.....	4
Figure 2. Pamje nga hyrja e manastirit	11
Figure 3. Pamja nga konaku lindor	11
Figure 4. Pamje nga konaku perëndimorë	12
Figure 5. Foto nga konaku lindor.....	15
Figure 6. Planimetri kati përdhe.....	17
Figure 7. Planimetri kati I	17
Figure 8. Prerja A-a.....	18
Figure 9. Prerja B-B.....	18
Figure 10. Prerja C-C	18
Figure 11. Fasada perëndimore	19
Figure 12. Fasada lindore.....	19
Figure 13. Fasada veriore.....	19

1. Hyrje

Ndërtesat e trashëgimise kulturore janë te pazëvendësueshme dhe shumë komplekse, ato evoluojnë në kohë dhe si rjedhojë përmbajnë shumë elementë dhe sisteme të trashëgimisë.

Këto asete po bëhen shumë të çënueshme për shkak të ndryshimeve konstante dhe transformimeve të mjedisit jetësor, ndryshimet sociale, lëvizjeve demografike, aktivitetit sizmik dhe ndryshimeve klimaterike. I tillë është edhe rasti i Manastirit të Kryeengjëjve në Dervician në Luginën e Drinosit.

Raporti aktual diskuton gjendjen ekzistuese dhe propozimin për Restaurimin e Konakut Lindor në Manastirin e Dervicianit. Së fundmi në raport do të shtjellohen ndërhyrjet e propozuara si dhe specifikimet e nevojshme për realizimin e këtyre ndërhyrjeve.




Figure 1. Manastiri i Dervicianit

2. Objektivat

Qëllimi kryesor i këtij projekti është që në përfundim të kemi një qasje të strukturuar mbi propozimin e konservimit të Manastirit të "Kryeengjëjve" në Dervician. Zhvillimi i projektit do të bazohet në dokumentimin e gjendjes ekzistuese, hartimin e propozimit të ndërhyrjeve, si dhe në paraqitjen e gjendjes përfundimtare pas realizimit të punimeve konservuese.

Në këtë fayë ne do të meremi me konsolidimin dhe ringritjen e një prej objekteve në këtë manastir, atë të Konakut Lindor.

Si fillim, duhet të kryhet një rishikim gjithëpërfshirës i metodologjive që lidhen me identifikimin e patologjive dhe analizën strukturore të ndërtesave historike. Kjo qasje do të mundësojë përzgjedhjen e metodës më të përshtatshme për evidentimin dhe vlerësimin e problematikave.

Së dyti, kërkimi i detajuar i materialit arkivor do të ndihmojë në kuptimin më të plotë të gjendjes së monumentit, morfologjisë së manastirit, si dhe të ndryshimeve të ndodhura gjatë periudhave të ndryshme historike.

Së treti, investigimi i tipologjisë strukturore, materialeve ndërtimore dhe teknikave të ndërtimit do të jetë shumë i rëndësishëm për përcaktimin e mënyrës së ndërhyrjeve.

Së fundmi, përcaktimi i ndërhyrjeve me qëllim përforcimin strukturor dhe konservimin e muraturës duhet të sigurojë jetëgjatësinë e strukturës për shekujt në vijim.

3. ANALIZA HISTORIKE

3.1 Zhvillimi historic i Manastireve

Fillesat e jetës monastike lidhen me veprimtarinë e disa të krishterëve, të cilët vendosën të jetonin në vetmi si eremitë ose të ndiqnin një disiplinë të rreptë shpirtërore, duke refuzuar të gjitha format e kënaqësive tokësore. Ata e bënë këtë sepse besonin se, pa shpërqendrim materiale apo shqetësime të botës tokësore, do të mund të afroheshin më shumë me Perëndinë dhe të kuptonin më mirë vullnetin e Tij.

Përveç kësaj, sa herë që të krishterët e hershëm përndiqeshin, ata detyroheshin të strehoheshin në zona të thella malore, ku mungonin kushtet dhe mjetet bazë të jetesës. Me rritjen e numrit të këtyre individëve, disa prej tyre filluan të jetonin së bashku në komunitete, duke vazhduar megjithatë të shkëputeshin nga pjesa tjetër e shoqërisë dhe duke iu përkushtuar tërësisht lutjes dhe studimit të shkrimeve të shenjta.

Fillimisht, anëtarët e këtyre komuniteteve jetonin në një vend të njohur si *lavra*, ku vazhdonin jetën e tyre të vetmuar dhe mbledheshin së bashku vetëm për shërbesa fetare. Udhëheqësi i tyre, një aba (abati i mëvonshëm), kryesonte mbi këta individë. Ata quheshin *monachos* në greqisht, fjalë që rrjedh nga *mono*, që do të thotë “një”, dhe që përbën origjinën e fjalës “murg”.

Manastiret e para komunale (cenobitike) u administruan sipas një grupi rregullash të hartuara nga Pachomios. Ky stil jetese komunale (*koinobion*), ku murgjit jetonin, punonin dhe adhuronin së bashku në një rutinë të përditshme, me të gjitha pronat e mbajtura në mënyrë të përbashkët dhe nën drejtimin e një

abati, u bë modeli mbizotërues gjatë periudhës bizantine.

Hapi tjetër në zhvillimin e manastireve, drejt formës që u bë standarde gjatë Mesjetës, u ndërmor nga Vasili i Qesarisë (i njohur ndryshe si Shën Vasili ose Vasili i Madh, rreth viteve 330–379 pas Krishtit) në shekullin e IV. Vasili kishte vizituar personalisht manastiret e Egjiptit dhe Sirisë dhe kërkoi të përhapte këtë model në të gjithë Perandorinë Romake të Lindjes (Bizantine).

Ai shtoi një element të ri, të bazuar në bindjen se murgjit jo vetëm duhet të jetojnë dhe të punojnë së bashku për qëllime të përbashkëta, por edhe të kontribuojnë në mënyrë aktive për komunitetin më të gjerë. Manastiret bizantine ishin organizata të pavarura, me rregullat dhe normat e tyre të brendshme për jetën e murgjve.

3.2 Vendodhja

Manastiri i Kryeengjëjve (Dervician) është një monument i trashëgimisë kulturore i kategorisë së dytë në Dervician, rrethi i Gjirokastrës, në qarkun e Gjirokastrës, në Shqipëri.

Shtrihet përgjatë luginës së Drinosit, në rrezë të Malit të Gjerë dhe të Stugarës.

Koordinatat gjeografike të monumentit janë:

Gjatësi gjeografike : 20°09'51.5"E

Gjerësi gjeografike : 40°01'51.2"N

3.3 Morfologjia dhe Organizimi funksional

Manastiri i Dervicianit është ndërtuar në një parcel të sistemuar me dy tarraca dhe është i rrethuar me mure. Ndërtimet që formojnë manastirin janë:

- a. Kisha, e vendosur në qendër,
- b. Konakët në anën lindore,
- c. Ndërtimet ndihmëse në anën perëndimore

a. Kisha

Brenda një oborri të mbrojtur nga muret rrethuese ngrihen dendur me njëri-tjetrin ndërtime të funksioneve dhe të kohërave të ndryshme, duke lënë rreth tyre rrugica të ngushta, të shtruara me pllaka guri.

Kisha është ndërtimi kryesor i manastirit. Ajo përbëhet nga naosi dhe narteksi. Naosi ishte i tipit në formë kryqi me kupolë, triapsidal, me përmasa të brendshme $6,90 \times 3,80$ m. Por, ndërsa kompozimi planimetrik është i njëjtë me atë të kishave të tjera të së njëjtës krahinë, ai ndryshon nga kompozimi volumor. Këtu krahu verior dhe ai jugor i kryqit, ndonëse më të ngushtë, janë më të theksuar për shkak të lartësisë së tyre më të madhe në krahasim me krahët lindorë dhe perëndimorë. Rëndësia e nefit tërthor rritet akoma më tepër nga zgjerimi i hapësirës së tij nëpërmjet daljes së apsidave anësore.

Bërthama qendrore në formë drejtkëndëshi mbulohet me qemer të kryqëzuar, i cili nuk shfaqet mbi mbulesën e çatisë. Pjesët këndore, edhe këto me lartësi jo të barabartë, janë mbuluar me qemere cilindrike që hapen ndaj nefit qendror. Ambienti i altarit i ka pjesët përbërëse të formuara dhe të pajisura me apsidat dhe niket përkatëse. Interieri ndriçohet nga dritaret e hapura në muret e apsidave.

Naosi lidhet me narteksin në anën perëndimore. Narteksi është dykatësh. Një shkallë guri në murin verior shërben për lidhjen e të dy kateve. Kati përdhe, me lartësi të madhe dhe pa dritare, ishte i mbuluar me qemer cilindrik. Kati i sipërm, me funksion të papërcaktuar qartë, ka lartësi të vogël, dritare të shumta, por pa tavan. Mbi frontonin e murit perëndimor të narteksit ngrihet kambanorja me dy kamare (hapësira të harkuara) në pjesën e poshtme dhe një të tretë mbi to.

Ndryshimi i teknikës, materialit dhe i elementeve arkitektonike e dekorative të përdorura na shtyn të mendojmë se kati i sipërm i narteksit duhet të jetë shtuar më vonë, gjatë një rikonstruksioni tërësor të narteksit.

Në pamjen e jashtme, volumi prizmatik i zgjatur dhe i mbuluar me çati dyujëse, nga i cili dalin vetëm tri volumet e apsidave, ka fshehur plotësisht strukturën e brendshme. Si në të gjitha kishat e Dropullit, edhe këtu është përdorur e njëjta teknikë ndërtimi: muraturë me gurë shtresorë, të vendosur në radhë të rregullta e të lidhur me llaç gëlqereje, që krijojnë sipërfaqe të pastër. Mbulesa e çatisë është me rasa guri.

Rrafshësia e muraturës thyhet vetëm te apsidat, të cilat janë të përpunuara me nike të shkallëzuara e të harkuara nga sipër, harqet e të cilave janë ndërtuar me gurë të alternuar me tulla. Muratura përfundon me kornizë prej gurësh të vendosur në formë dhëmbësh sharre.

Ndryshe janë realizuar detajet arkitektonike në narteks. Mbulesat e portës dhe të dritareve janë të rrafshta, të realizuara me arkitrarë prej guri, sipër të cilave janë ndërtuar harqe shkarkuese që lehtësojnë ngarkesën mbi arkitrarët. Korniza me pllaka guri është shumë e dalë dhe mbahet me konsola guri. Një kornizë e tillë është ndërtuar edhe në mes të lartësisë së murit perëndimor të narteksit, në nivelin e ndarjes së kateve.

Si kohë ndërtimi, në mungesë të mbishkrimeve, duke u nisur nga tiparet e kompozimit të brendshëm dhe të formulimit arkitektonik të jashtëm, si dhe të teknikës dhe elementeve arkitektonike të përdorura, jemi të prirur ta konsiderojmë shekullin XVIII si periudhën e ndërtimit. Në këtë periudhë kishat në formë kryqi

bëhen gjithnjë e më të rralla dhe mbizotërojnë ndërtimet bazilikale, me të cilat, siç e vumë re më sipër, kisha e Manastirit të Kryeengjëjve ka shumë tipare të ngjashme.

Më pas, manastiri duhet të ketë pasur një funksionim tepër aktiv, gjë që dëshmohet nga datat e shumta të shekullit XIX. Kështu, data 21 qershor 1869 gjendet pranë portretit të igumen Makarit mbi portën e naosit, i cili përmendet për aktivitetin e tij në pasurimin e manastirit. Data 16 shtator 1856 mbi portën veriore të manastirit tregon kohën e ndërtimit të mureve rrethuese. Data 7 nëntor 1864 gjendet në ikonën e Shën Gjergjit të Ri të Janinës, pikturuar nga A. Dhami dhe Kristo Samarina. Data 3 qershor 1869 gjendet e pikturuar në apsidën e kishës, realizuar nga Zisi Mihali dhe Gjergji nga katundi Samarina, ndërsa mbishkrimi nr. 786 na njeh me pikturimin e narteksit të kishës.

b. Konakët

Konaku mbyll oborrin në anën lindore. Kati përdhe përdorej si katua, ndërsa kati i dytë shërbente për banim. Pamja nga oborri është trajtuar me galeri të hapura, ndërsa ajo nga jashtë është e mbyllur në katin përdhe dhe me dritare në formë harku në katin e banuar. Pjesa juglindore e ndërtesës përmban hyrjen për në manastir në katin përdhe, e cila është e mbrojtur nga një krah i dalë i ndërtesës. Mbi portën zhvillohet një çardak i hapur, i cili zgjatet mbi portë në formë ballkoni. Prej tij hapet një pamje e gjerë mbi luginën e Dropullit.

Në pjesën perëndimore të manastirit ndodhen konakët që përdoreshin për përgatitjen dhe konsumimin e ushqimit.

Objekti, në tërësinë e tij, paraqet një organizim në nivele të ndryshme. Kuzhina është e vendosur në një nivel më të lartë dhe lidhet me trapezarinë, e cila kompenson këtë disnivel përmes një bodrumi të vendosur poshtë saj. Ky bodrum komunikon me trapezarinë nëpërmjet një sistemi shkallësh. Historikisht, ai është përdorur për ruajtjen e rezervave ushqimore dhe të verës.

Hajati që shtrihet përpara këtyre ambienteve, megjithëse me gjerësi të kufizuar, është një element i rëndësishëm funksional, pasi siguron lidhjen ndërmjet kuzhinës dhe trapezarisë, si dhe mundëson lëvizjen e besimtarëve brenda kompleksit manastiror.

3.4 Fazat Ndërtimore

Supozohet se faza e parë ndërtimore ka qenë kisha e manastirit dhe më pas, në një periudhë më të vonshme, janë ndërtuar të gjitha strukturat që ndodhen përreth saj. Në këtë rast, fazat ndërtimore do të identifikohen duke u bazuar në arkeologjinë e ndërtesës, e cila na mundëson identifikimin relativ të ndërhyrjeve në rastet kur mungon informacioni arkivor.

Zakonisht, kishat e manastireve janë ndërtuar mbi rrënojat e një kishe tjetër, ndoshta më të vogël, e cila ka shërbyer si vend i shenjtë. Megjithatë, për shkak se nuk disponojmë informacione mbi të kaluarën e sitit të manastirit, do të trajtojmë vetëm elementet e evidentuara në terren dhe ato të dokumentuara në arkivin e IKTK-së.

Kisha, e përbërë nga naosi, është ndërtuar në shekullin XVIII. Fillimisht është ndërtuar hapësira e kishës dhe më pas, në një fazë të dytë, është ndërtuar narteksti, i cili dallohet qartë nga ndarja me fugë, që evidenton faza të ndryshme ndërtimore.

Hajati i përket një faze të tretë të zhvillimit të kishës. Ai është një ndërtim më i vonshëm se narteksti, pasi muret e hajatit mbështeten në muret e narteksit.

Muret e jashtme të konakëve shërbejnë gjithashtu si mur rrethues i manastirit dhe trajtimi i fazave të tyre do të analizohet në tërësi. Në fazën fillestare, konfigurimi i manastirit duhet të ketë qenë i ndryshëm nga ai që shohim sot. Hapësirat që aktualisht njihen si hapësira ndihmëse mendohet se kanë qenë ndër ndërtimet e para, ndërsa më vonë janë shtuar hapësirat e tjera.

Ndërtimi i mureve, bashkimet në fuga dhe mbivendosja e strukturave më të vona mbi ato më të hershme japin tregues të rëndësishëm mbi konfigurimin fillestar të manastirit. Në të dy krahët e ndërtimeve ndihmëse vërehet se muret rrethuese bashkohen me këto hapësira. Për këtë arsye, supozohet se ndërtimet ndihmëse kanë qenë ndër strukturat më të hershme të manastirit.

Edhe konakët dallohen të paktën në dy faza ndërtimore. Faza më e hershme është ajo me qemer, ndërsa faza e mëvonshme lidhet me zëvendësimin e qemerit me dyshme druri dhe shtimin e një kati të ri. Si pasojë e këtij ndryshimi, është ndërtuar edhe një mur i dytë në pjesën e brendshme, i cili evidentohet qartë edhe në dokumentacionin e IKTK-së.

3.5 Ndërhyrjet ndër vite

Dokumentacioni arkivor daton nga viti 1967 dhe është hartuar nga autori R. Baholli. Në këtë dokumentacion paraqiten pamjet e Manastirit, ku dallohen qartë fasadat jugperëndimore, verilindore, veriore dhe jugore.

Në dokumentacion janë evidentuar edhe afresket dhe mbishkrimet, të cilat datojnë si më poshtë:

- Data 21 qershor 1869 gjendet pranë portretit të igumen Makarit, mbi portën e naosit, i cili përmendet për veprimtarinë e tij në pasurimin e manastirit.

- Data 16 shtator 1856, e vendosur mbi portën veriore të manastirit, tregon kohën e ndërtimit të mureve rrethuese.
- Data 7 nëntor 1864 gjendet në ikonën e Shën Gjergjit të Ri të Janinës, e pikturuar nga A. Dhami dhe Kristo Samarina.
- Data 3 qershor 1869 gjendet e pikturuar në apsidën e kishës, vepër e Zisi Mihalit dhe Gjergjit nga fshati Samarinë.

Gjithashtu, mbishkrimi nr. 786 jep të dhëna mbi pikturimin e narteksit të kishës.

Nga studimi i materialit arkivor rezulton se në Manastirin e Dervicianit është kryer një ndërhyrje gjatë viteve 1967–1968, për të cilën disponohet vetëm dokumentacioni i hartimit të projektit dhe jo ai i realizimit të punimeve. Ndërhyrjet e parashikuara konsistojnë kryesisht në restaurimin e konakëve në krahun lindor të manastirit. Këto ndërhyrje përfshijnë konsolidimin e muraturës, restaurimin e dyshemeve, restaurimin e elementeve të çardakut dhe restaurimin e çatisë. Nga këto ndërhyrje restauruese nuk mund të identifikohet asnjë gjurmë në gjendjen aktuale, pasi këto struktura janë shembur.

Pas viteve '90, manastiri u la në harresë nga institucionet shtetërore dhe, si pasojë, strukturat e konakëve dhe ambientet ndihmëse pësuan degradim progresiv. Sot ato gjenden në gjendje rrënoje dhe kanë nevojë urgjente për ndërhyrje konsoliduese dhe konservuese.

Kohët e fundit, banorë të komunitetit lokal, të ndërgjegjësuar për rëndësinë e ruajtjes së manastirit, kanë mbledhur kontribute vullnetare dhe kanë realizuar disa punime me karakter stabilizues. Këto punime kanë konsistuar në riparimin e çatisë së kishës, vendosjen e dyerve, riparimin e qemerëve në portat hyrëse, si dhe ndërhyrje të tjera të vogla me qëllim mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e monumentit.



Figure 2. Pamje nga hyrja e manastirit



Figure 3. Pamja nga konaku lindor



Figure 4. Pamje nga konaku perëndimorë

4. GJENDJA EKZISTUESE

4.1 Gjendja stukturore e muraturës

Lënia në harresë dhe shembja e strukturave të konakëve dhe ambienteve ndihmëse e kanë ekspozuar muraturën ndaj agjentëve natyrorë. Faktori më problematik është penetrimi i ujërave të shiut, i cili bën që muratura të humbasë elementin lidhës dhe, për rrjedhojë, të humbasë qëndrueshmërinë dhe të dalë nga vertikalteteti.

Pjesa e konakëve paraqet patologji të theksuara në tërësinë e saj. Çatia në këtë pjesë ka humbur plotësisht elementët strukturorë dhe rrasat e gurit të mbulimit; me kalimin e kohës ato janë kolapsuar si pasojë e braktisjes dhe mungesës së mirëmbajtjes për një periudhë të gjatë.

Sa i përket muraturës së konakëve, ajo paraqitet në gjendje të amortizuar. Evidentohet humbje e materialit lidhës, dëmtime dhe mungesa të pjesshme në muraturën e gurit, si dhe devijime nga vertikalteteti. Për shkak të ekspozimit ndaj kushteve atmosferike, edhe brezat e drurit janë dekompozuar, çka e bën të domosdoshëm restaurimin ose zëvendësimin e tyre, sipas rastit.

Për sa i përket konakut lindor, që në hyrje të objektit vihet re mungesa e strehës së portës hyrëse; në vend të saj janë vendosur rrasë guri mbi muraturën dhe qemerin e portës. Muri perëndimor është relativisht në gjendje më të mirë në krahasim me pjesën tjetër të objektit, megjithatë paraqet patologji të theksuara, si çarje dhe humbje të llaçit lidhës për shkak të amortizimit nga koha dhe mungesa e mirëmbajtjes.

Muri verior i konakut është rrënuar dhe degraduar në masën rreth 80%, ndërsa muratura e mbetur ka

humbur vertikalitetin dhe materialin lidhës. Muret e fasadave lindore dhe jugore janë në gjendje disi më të mirë, por edhe këtu evidentohen patologji të theksuara, si humbja e elementeve të muraturës, devijime nga vertikaliteti, si dhe dëmtim e kalbje të brezave të drurit.

Në pjesën e brendshme të konakut vërehen të njëjtat problematika: devijime të muraturës nga vertikaliteti, mungesë e llaçit lidhës dhe degradim i brezave të drurit. Gjithashtu konstatohet dëmtim i qemereve dhe prani e bimësisë së lartë dhe të ulët. Dyshemetë janë shembur, së bashku me trarët mbajtës.

Sa i përket dritareve, është i nevojshëm restaurimi i arkitrarëve dhe plotësimi i pjesëve ku muratura ka humbur. Po ashtu, kërkohet vendosja e dritareve të reja në vend të atyre që janë humbur ose amortizuar me kalimin e kohës.

E njëjta situatë paraqitet edhe për dyert. Aktualisht vihet re se arkitrarët janë të amortizuar për shkak të ekspozimit, ndërsa vetë dyert kanë humbur si pasojë e mungesës së mirëmbajtjes. Kolonat e gurit në pjesën veriore të konakut janë pjesërisht të ruajtura, por disa prej tyre janë rrënuar. Kolonat e mbetura kërkojnë restaurim dhe rivendosje në vertikalitet.

Pranë portës perëndimore ndodhen shkallët e gurit, të cilat janë të dëmtuara dhe paraqesin mungesë të kapakëve të shkallëve. Në fasadat jugore dhe lindore evidentohet prani e theksuar e bimësisë, ndërsa edhe në brendësi të konakut ka zhvillim të bimësisë së lartë dhe trungjeve.

Në konakun perëndimor, patologjitë janë edhe më të theksuara. Në pjesën lindore të tij vihet re një ndërhyrje e vonë, e cila ruan konturimin e muraturës në këtë segment, ndërsa në pjesët ngjitur muratura është tërësisht e rrënuar. Në pothuajse të gjithë perimetrimin evidentohen humbje të elementeve të muraturës dhe devijime nga vertikaliteti. Muratura ekzistuese paraqet humbje të llaçit lidhës, si dhe degradim të brezave të drurit.

Dyshemetë e katit të parë janë zhdukur plotësisht, së bashku me trarët mbajtës. Nga vëzhgimi në terren rezulton se edhe dyshemetë e katit përdehe kanë pësuar humbje të rrasave të gurit. Shkallët e drurit janë zhdukur për shkak të kolapsit të objektit, ndërsa ato prej guri kërkojnë restaurim dhe zëvendësim të elementeve të dëmtuara.

Kolonat e gurit janë dëmtuar rëndë dhe kërkojnë rindërtim. Për shkak të patologjive të përhapura në muraturë, si humbja e vertikalitetit dhe e materialit lidhës, këto probleme reflektohen edhe në elementët e dyerve dhe dritareve, ku arkitrarët dhe pjesët prej druri janë dëmtuar ose zhdukur plotësisht. Gjithashtu, evidentohen dëmtime të theksuara në qemere.

Objekti paraqet prani të konsiderueshme të bimësisë së ulët dhe të lartë, e cila ka kontribuar në degradimin e mëtejshëm të muraturës. Në pjesën perëndimore të manastirit, muri ekzistues ka humbur plotësisht vertikalishtet dhe rrezikon shembjen drejt pjesës së brendshme të objektit.

Në të dy objektet konstatohet mungesa e çatisë dhe rrëzimi i saj në brendësi, çka ka sjellë depozitimin e rrasave të gurit në ambientet e brendshme. Gjithashtu, struktura e çatisë dhe elementët prej druri janë humbur plotësisht.





Figure 5. Foto nga konaku lindor

5. PROPOZIM

Manastiri i Dervicianit, në aspektin strukturor, përfaqëson një strukturë të thjeshtë, e cila gjatë shekujve ka pësuar modifikime si pasojë e rrethanave historike. Dokumentimi dhe investigimi i detajuar i të gjitha problematikave na ndihmuan të kuptojmë patologjitë, defektet dhe shkaqet që kanë çuar në shfaqjen e tyre. Bazuar në këto të dhëna, u propozuan masat e mëposhtme, të cilat synojnë përmirësimin e gjendjes së monumentit dhe adresimin e problematikave të evidentuara.

Me ndërhyrjet e propozuara për konservimin e Manastirit të “Kryeengjëjve” në Dervician, në Luginën e Drinosit, synohet ruajtja e gjendjes ekzistuese të monumentit, duke treguar respekt ndaj materialit origjinal, morfologjisë së tij dhe transformimeve strukturore të ndodhura ndër shekuj. Gjithashtu, në këtë propozim është treguar respekt ndaj teknikave tradicionale të ndërtimit, si dhe ndaj devijimeve dhe ndryshimeve që kanë karakterizuar fazat e ndryshme të zhvillimit historik të manastirit.

5.1 Konsolidimi strukturor i muraturave prej guri (me dy parete dhe mbushje në mes me teknikën e injektimit)

Në çarjet e muraturës që zhvillohen përgjatë fugave do të kryhet injektimi i llaçit me lidhës gëlqereje ajrore dhe shtesa puzolanike, ose me llaç me gëlqere hidraulike natyrore, pa shtesa çimentoje apo rrëshire.

Në rast se llaçi mbushës do të ketë si lidhës gëlqeren ajrore, do të shtohen materiale puzolanike (pluhur tulle, rërë vullkanike etj.) për të përmirësuar vetitë mekanike dhe qëndrueshmërinë e tij. Llaçi duhet të

ketë veti të mira injektimi, të mos shfaqë tkurrje dhe të arrijë një rezistencë në shtypje prej 0.7–1 N/mm² pas 28 ditësh.

Injektimi do të realizohet me teknikën e rënies së lirë të përzierjes, duke përdorur llaç me rezistencë të lartë mekanike dhe me rrjedhshmëri të përshtatshme për depërtimin në boshllëqet e muraturës.

Përpara procesit të injektimit duhet të kryhen disa punime parapërgatitore për përgatitjen e muraturës:

- Muratura duhet të lahet me ujë për të larguar pluhurin, papastërtitë dhe materialet e shkëputura.
- Duhet të kryhet fugatimi paraprak për të bllokuar daljet e mundshme të llaçit gjatë injektimit.
- Muratura duhet të njomet mjaftueshëm për të shmangur thithjen e menjëhershme të ujit nga llaçi dhe tharjen e shpejtë të tij.
- Injektimi duhet të kryhet nga poshtë lart, sipas udhëzimeve dhe kushteve të evidentuara në terren.

5.2 Konsolidimi dhe rindërtimi pjesor i muraturës me teknikën ekzistuese

Përveç dëmtimeve të evidentuara në muraturë, në disa zona janë shkëputur edhe fragmente të saj, të cilat kërkojnë rindërtim ose plotësim. Me qëllim ruajtjen sa më besnike të karakterit historik dhe konstruktiv të manastirit, rekomandohet rindërtimi i pjesëve të shembura të muraturës nëpërmjet ripërdorimit të gurëve origjinalë të rënë nga struktura.

Në këtë mënyrë sigurohet ruajtja e autenticitetit material dhe formal të monumentit, duke respektuar teknikën tradicionale të ndërtimit, tipologjinë e muraturës dhe karakteristikat e materialeve ekzistuese. Për shkak të disponueshmërisë së elementeve origjinale dhe lexueshmërisë së qartë të strukturës së mëparshme, rindërtimi i këtyre fragmenteve paraqet një ndërhyrje teknikisht të realizueshme dhe relativisht të thjeshtë.

5.3 Rindërtimi i çatisë së konakut

Nga verifikimi në terren rezulton se konaku paraqitet pa çati, pasi kjo e fundit është shembur plotësisht dhe nuk ruhen elemente të saj konstruktive. Mungesa e mbulesës ka ekspozuar muraturat dhe hapësirat e brendshme ndaj veprimit të drejtpërdrejtë të faktorëve atmosferikë, duke përshpejtuar proceset e degradimit të objektit.

Për të siguruar mbrojtjen dhe ruajtjen e ndërtesës, propozohet rindërtimi i plotë i çatisë, duke u bazuar në

gjurmët e ruajtura në muraturë, dokumentacionin historik, analogjitë tipologjike dhe karakteristikat tradicionale të arkitekturës së objektit. Ndërhyrja synon rikthimin e volumit dhe konfigurimit origjinal të çatisë, duke respektuar formën, pjerrësinë dhe zgjidhjet konstruktive tradicionale.

Mbulesa e re do të realizohet me rasa guri, material karakteristik i përdorur historikisht në zonë dhe në objektet e kësaj tipologjie, me qëllim ruajtjen e autenticitetit arkitektonik dhe harmonizimin me karakterin historik të monumentit. Të gjitha punimet do të kryhen duke respektuar parimet e restaurimit dhe konservimit të trashëgimisë kulturore, me synimin për t'iu afruar sa më shumë pamjes dhe funksionit që çatia ka pasur në gjendjen e saj origjinale.




Figure 6. Planimetri kati përdhe




Figure 7. Planimetri kati I




Figure 8. Prerja A-a




Figure 9. Prerja B-B




Figure 10. Prerja C-C




Figure 11. Fasada perëndimore




Figure 12. Fasada lindore




Figure 13. Fasada veriore



Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastrë, Shqipëri. Tel: +355 84 26 9001

E-mail: drtkgjirokaster@meki.gov.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE
SEKRETARIA TEKNIKE
DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE GJIROKASTËR**



SPECIFIKIME TEKNIKE

**PROJEKT RESTAURIMI MANASTIRI I KRYEENGJËJVE NË DERVICIAN
GJIROKASTËR**

GJIROKASTËR 2026



**Adresa: Rruga Dr.Vasil Laboviti Nr. 3, Lagjia Varosh, Gjirokastrë, Shqipëri. Tel: +355 84 26 9001
E-mail: drtkgjirokastrë@meki.gov.al**





Përmbledhja:

1. SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME	3
2. DORËZIMET TE MBIKQYRËSI I PUNIMEVE:.....	5
3. MBROJTJA:	7
4. SHËRBIMET E JASHTME:	9
5. TRANSPORTI DHE MAGAZINIMI I MATERIALEVE.....	10
6. PASTRIMI PËRFUNDIMTAR I ZONËS	10
7. PUNIME PRISHJEJE-ÇMONTIMI DHE PASTRIMI	10
8. NDËRHRYJE KONSERVUESE DHE RESTAURUESE	14
9. PUNIMET QË DO TË KRYHEN:	15



1. SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME

1.1 Njësitë matëse:

Në përgjithësi njësitë matëse kur lidhen me Kontratat janë njësi metrike në mm, cm, m, m², m³, Km, N (Njuton), Ton (1000 kg) dhe gradë celcius. Pikat dhjetore janë të shkruara si “.”.

1.2 Qëllimi i punës:

Kontraktori duhet të bëjë kujdes në zbatimin e punimeve sipas projektit të miratuar në KKR në përputhje dhe me kushtet e kontratës si dhe të plotësojë çdo difekt gjatë punimeve. Kontraktuesi do të sigurojë që drejtuesi teknik i punimeve restauruese të jetë prezent gjatë gjithë procesit të zbatimit të punimeve, gjithashtu personeli i kualifikuar për këto tipologji punimesh. Kontraktuesi do të sigurojë materialet, pajisjet dhe të gjitha sendet e tjera, qoftë të një natyre të përkohshme ose të përhershme, të nevojshme për zbatimin dhe përfundimin e punëve, dhe për korrigjimin e ndonjë defekti, për aq sa është e specifikuar në këtë dokument, ose mund të nxirret në mënyrë të arsyeshme gjatë zbatimit të kontratës nga Drejtuesi i Projektit më tej i quajtur Mbikqyrësi i Punimeve.

1.3 Grafiku i punimeve:

Kontraktuesi duhet t’i japë Mbikqyrësit të Punimeve një program të plotë duke i treguar rendin, procedurën dhe metodën sipas së cilave, ai propozon të punohet në restaurim deri në mbarim të punës.

Informacioni që duhet ti sigurohet mbikqyrësit të punimeve duhet të përfshijë:

- Vizatime grafike që tregojnë rregullimin gjeneral të ambienteve të ansamblit dhe të ndonjë ndërtimi apo strukture tjetër të përkohshme, të cilat ai i propozon për përdorim;
- detaje të vendosjes konstruksionale dhe punëve të përkohshme;
- plane të tjera që ai propozon t’i adaptojë për ndërtim e restaurim dhe përfundimin e të gjitha punëve, si dhe në vijim,
- detaje të fuqisë punëtore të kualifikuar.

Mënyra dhe rregulli që janë propozuar për të ekzekutuar këto punime permanente është temë për t’u

rregulluar dhe aprovuar nga Mbikqyrësi i Punimeve të restaurimit, dhe çmimi i kontratës duhet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

të jetë i tillë që të përfshijë çdo rregullim të nevojshëm, të kërkuar nga mbikqyrësi i punimeve gjatë zbatimit të punimeve.

1.4 Punime të gabuara:

Çdo punë, që nuk është në përputhje me projektin e aprovuar nga KKR, dhe këto specifikime, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë çdo defekt me shpenzimet e veta, sipas projektit. Në rastet kur kontraktori i punimeve restauruese gjykon të adaptojë punime gjatë procesit të restaurimit në funksion të këtij procesi, *çdo ndryshim bëhet me aprovim të Mbikqyrësit të Punimeve dhe këto adaptime nuk duhet të prekin thelbin e projektit.*

1.5 Punime të rrezikshme:

Magazinimi i bombolave të gazit me presion në ambjentet e brendshme të monumentit është e ndaluar. Gjatë punimeve të rrezikshme me gazrat e ndezshme duhet mbajtur fikësezjarrit sipas DIN EN 3 duhet të jetë në dispozicion pranë me vendin ku punohet.

1.6 Tabelat njoftuese, etj:

Asnjë tabelë njoftuese nuk duhet vendosur, përveç: Kontraktori do të ndërtojë dy tabela, që përmbajnë informacion të dhënë nga Mbikqyrësi i punimeve dhe vendosen në vendet e caktuara nga ai. Fjalët duhen shkruar në mënyrë të tillë, që të jenë të lexueshme nga një distancë prej 100 m. Gjuha e shkruar duhet të jetë në shqip.

1.7 Sigurimi Teknik:

Kontraktori do të zbatojë të gjitha punimet sipas standarteve Europiane dhe Shqiptare të sigurimit teknik në punë. Ai duhet të sigurojë një plan për sigurimin teknik dhe staf të kualifikuar për inspektimin e sigurimit teknik, kryerjen e instruktimit teknik për çdo punonjës dhe për çdo zë pune specifik. Gjatë punimeve të prishjes punëtorët duhet të veshin rroba të duhura të sigurisë duke përfshirë syze në mbrojtjen e syrit, maska pluhuri, këpucë të sigurisë, doreza të punës dhe kasketa të

forta. Mbajtjen e procesverbaleve për çdo lloj aksidenti në punë dhe mbarëvajtjen e sigurimit teknik



të cilin duhet tja prezantojë Mbikqyrësit çdo muaj.

2. DORËZIMET TE MBIKQYRËSI I PUNIMEVE:

2.1 Autorizimet me shkrim:

“Rregullat me shkrim” do t’i referohen çdo dokumenti dhe letre të nënshkruar nga Mbikqyrësi i Punimeve të dërguara kontraktuesit që përmbajnë instruksione, udhëzime ose orientime për kontraktorin në mënyrë që ai të realizojë zbatimin e kësaj kontrate. Fjalët e aprovuara, të drejtuara, të autorizuar, të kërkuara, të lejuara, të urdhëruara, të instruktuar, të emëruara, të konsideruara të nevojshme, urdhëresa ose jo (duke përfshirë emra, folje, mbiemra, dhe ndajfolje), aprovimet e shkruara, drejtimet, autorizimet, kërkesat, lejet, rregullat instruksionet, emërimet, urdhëresat e Mbikqyrësit të punimeve do të përdoren deri në daljen e një plani tjetër pune.

2.2 Dorëzimet tek Mbikqyrësi i punimeve:

Kontraktori duhet t’i dorëzojë Mbikqyrësit: *për çdo punim shtesë, një vizatim të detajuar dhe puna duhet të fillojë vetëm pas aprovimit nga Mbikqyrësi.* Kontraktori duhet të nënshkruajë propozime, detaje, skica, llogaritje, informacione, materiale, çertifikata testi, kurdo që të kërkohej nga Mbikqyrësi. Mbikqyrësi i Punimeve do të pranojë çdo dorëzim dhe nëse janë të përshtatshme do t’i përgjigjet kontraktorit në përputhje me çdo klauzolë përkatëse të kushteve të kontratës. Çdo pranim duhet bërë me data në marrëveshje me Mbikqyrësin e Punimeve dhe duke iu referuar programit të aprovuar dhe kohës së nevojshme që i duhet Mbikqyrësit për të bërë këto pranime.

2.3 Kopjimi i vizatimeve (Vizatimet siç është zbatuar)

Kontraktori duhet të përgatisë vizatimet për të gjitha punimet “siç janë zbatuar faktikisht” në terren. Gjatë zbatimit të punimeve në kantier, Kontraktori do të ruajë të gjithë informacionin e nevojshëm për përgatitjen e “Vizatimeve siç është zbatuar”. Do të shënojë në mënyrë të qartë vizatimet dhe të gjitha dokumentat e tjera të cilat mbulojnë punën e vazhdueshme të përfunduar. Këto vizatime do të azhurnohen në mënyrë të vazhdueshme dhe do t’i dorëzohen Mbikqyrësit të punimeve çdo muaj për aprovim, pasi punimet të kenë përfunduar, së bashku me kopjen përfundimtare. Materiali mujor do të dorëzohet në kopje letër.

Vizatimet e riprodhuara do të përfshijnë pozicionin dhe shtrirjen e të gjithë konstruksioneve mbajtëse



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

të lëna gjatë gjurmimeve dhe vendosjen ekzakte të të gjitha shërbimeve që janë ndeshur gjatë ndërtimit. Kontraktori gjithashtu duhet të përgatisë seksionet e profilit gjatësor të rishikuar, pajisur me shënimet që tregojnë shtresat e tokës që hasen gjatë të gjitha punimeve të gjurmimit.

Si përfundim, kopjet e riprodhuara të Vizatimeve, “siç është zbatuar” do t’i dorëzohen Mbikqyrësit për aprovim.

2.4 Mostrat:

Kontraktori duhet të sigurojë mostra, të etiketuara sipas të gjitha përshtatjeve, aksesoreve dhe tema të tjera që mund të kërkohen me të drejtë nga Mbikqyrësi për inspektim. Mostrat duhen dorëzuar në zyrën e Mbikqyrësit.

2.5 Zëvendësimet

Zëvendësimi i materialeve të specifikuara do të bëhet vetëm me aprovimin e Mbikqyrësit të Punimeve i cili duhet të jetë i argumentuar dhe në funksion të përmirësimit të cilësisë apo origjinalitetit të veprës. Nëse materiali i propozuar për tu zëvendësuar është i njëjtë ose më i mirë se materialet e specifikuara; ose nëse materialet e specifikuara nuk mund të sillen në sheshin e ndërtimit në kohë për të përfunduar punimet e Kontratës për shkak të kushteve jashtë kontrollit të Kontraktorit, që kjo të merret në konsideratë, kërkesa për zëvendësim do të shoqërohet me një dokument dëshmi të cilësisë.

2.6 Vizatimet e punimeve të zbatuara dhe librezat e masave:

Kontraktori do t’i përgatisë dhe dorëzojë Mbikqyrësit tre grupe të dokumentacioneve të punimeve sipas projektit. Ky material duhet të përmbajë një komplet të vizatimeve të projektit të zbatuar, vizatimet shtesë të bëra gjatë zbatimit të punimeve të aprovuara nga Mbikqyrësi, si dhe librezat e masave për çdo volum pune.

2.7 Dokumentat dhe vizatimet:

Kontraktori do të verifikojë të gjitha dimensionet, sasinë dhe detajet të treguara në Vizatimet, Grafikët, ose të dhëna të tjera dhe Punëdhënësi nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë mangësi ose



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

mospërputhje të gjetur në to. Mos zbulimi ose korrigjimi i gabimeve ose mospërputhjeve nuk do ta lehtësojë Kontraktorin nga përgjegjësia për punë të pakënaqëshme. Kontraktori do të marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë në bërjen e llogaritjeve të madhësive, llojeve dhe sasive të materialeve dhe pajisjeve të përfshira në punën që duhet bërë sipas Kontratës. Ai nuk do të lejohet të ketë avantazhe nga ndonjë gabim ose mospërputhje, ndërsa një udhëzim i plotë do të jepet nga Punëdhënësi nëse gabime të tilla ose mospërputhje do të zbulohen.

2.8 Fotografitë e sheshit të ndërtimit;

Kontraktori duhet të bëjë fotografi me ngjyra sipas udhëzimeve të Mbikëqyrësit të Punimeve në vendet e punës për të demonstruar kushtet e sheshit përpara fillimit, progresin gjatë punës së ndërtimit dhe mbas përfundimit të punimeve.

3. MBROJTJA:

3.1 Puna ekzistuese:

Para fillimit të punëve Kontraktuesi së bashku me Mbikqyrësin duhet të inspektojnë dhe të identifikojnë të gjitha njësitë ekzistuese të cilat do të mbahen ose të ripërdoren. Një punë e tillë ekzistuese e cila është: (a) të mbeten në vend, (b), për ripërdorim, ose (c) të mbetet pronë e Klientit, do të mbrohet duke përdorur mbulesa të përkohshme, përforcuese dhe parandaluese. Objektet të cilat do mbeten dhe të cilat janë të dëmtuara gjatë kryerjes së punës do të riparohen në gjendjen e tyre origjinale ose të zëvendësohen me të reja me shpenzimet e Kontraktuesit. Nuk duhet të mbingarkohen elementet strukturore. Duhet siguruar mbështetje të reja dhe përforcime për ndërtimet dobësuar ekzistuese nga punimet e prishjeve. ***Në asnjë moment për cfarëdolloj arsye nuk duhet të rrezikohet struktura.*** Nëse vihet re humbja e stabilitetit të strukturës (devijime të mëdha) atëherë Kontraktuesi do të marrë masa të menjëhershme për të siguruar punimet dhe të evakujë dhe të izolojë zonën dhe të informojë Mbikqyrësin.

3.2 Zbritja e Materialeve:

Kur materialet ose mbeturinat zbriten nga lartësitë, kujdes duhet të merret për të parandaluar levizjet e materialeve, rënien në mënyrë të tillë që ajo krijon një rrezik për sigurinë e personelit ose të pronës



publike të çdo lloji.

3.3 Shërbimet ekzistuese:

Telat ekzistuese elektrike dhe përcjellës që mbeten do të shkëputen me kujdes nga instalimet/kapëset e tyre (pa shkëputje), të ripozicionohen jashtë vendeve ku aktualisht punohet dhe të mbrohen nga dëmtimi. Para prishjes së punimeve kontraktuesi do të kontrollojë për vendndodhjen e shërbimeve të padukshme.

3.4 Dëmtimet gjatë Dimrit:

E gjithë ndërtesa duhet të jetë e mbrojtur nga dëmet e dimrit të tilla si ngrirja se tubave të ujit etj gjatë punimeve të prishjeve. Nuk duhet të punohet në temperatura më të ulëta se 5°C.

3.5 Mbrojtja e punës dhe e publikut

Sipërmarrësi do të marrë masa paraprake për mbrojtjen e punëtorëve të punësuar dhe të jetës publike rreth sheshit të ndërtimit. Masat e sigurimit paraprak të ligjeve të aplikushme, kodeve të ndërtesave dhe të ndërtimit do të respektohen. Makineritë, pajisjet dhe çdo rrezik do të kqyren ose eliminohen në përputhje me masat paraprake të sigurimit.

Gjatë zbatimit të punimeve Sipërmarrësi duhet të vendosë dhe të mirëmbajë gjatë natës pengesa të tilla dhe drita të cilat do të parandalojnë në mënyrë efektive aksidentet. Sipërmarrësi duhet të sigurojë pengesa të përshtatëshme, shenja me dritë të kuqe “rrezik” ose “kujdes” dhe vrojtues në të gjitha vendet ku punimet mund të përbëjnë në ndonjë mënyrë rrezik për publikun.

3.6 Mbajtja pastër e ambjentit përreth monumentit:

Rruga hyrëse në objekt dhe ambjenti përreth tij që përdoret aktualisht si varrezë, do të mbahen pastër cdo ditë. Kontraktuesi do të marrë masat e nevojshme për të parandaluar dëmtimin e objekteve përreth dhe ambjentit duke siguruar hyrje / daljen e materialeve nga kantieri.

Mbrojtja e pemëve:

Të gjitha pemët të cilat nuk janë të aprovuara për prerjen duhet të mbrohen nga dëmtimi gjatë tërë periudhës së kontratës. Pemët me diametër më të madh se 10 cm dhe të larta deri 1m mbi tokë (shkurret, barërat etj) do të priten, pa lejen paraprake të autoriteteve dhe të mbikëqyrësit.



Mbrojtja e ambjentit

Sipërmarrësi duhet të ndërmarrë të gjithë veprimet e mundëshme për të siguruar që ambjenti lokal i ansamblit të ruhet dhe që vijat e ujit, toka dhe ajri (duke përfshirë edhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera.

4. SHËRBIMET E JASHTME:

4.1 Shërbimet elektrike dhe komunale

Duhet të mbrohen të gjitha shërbimet elektrike dhe komunale. Kontraktuesi do të zbulojë të gjitha shërbimet nëntokësore në kantier para fillimit të punimeve të gërmimit. Lejet e gërmimit do të merren nga furnizuesit e shërbimeve dhe një kopje do të dorëzohet tek Mbikqyrësi. Kur heqja e shërbimeve ekzistuese dhe kalldrëmit është specifikuar apo të nënkuptuara, do të sigurohen barrikada të miratuara, mbulimin e përkohshëm në zonat e ekspozuara dhe lidhje të përkohëshme për sistemet elektrike dhe të shërbimeve komunale. Distanca e nevojshme e punës të sigurt nga lart për linjat e tensionit të lartë do të caktohet dhe të miratohet me kompaninë e shpërndarjes elektrike. Një kopje e kësaj leje do të lëshohet nga Mbikqyrësi. Kontraktuesi do të ketë kohë të mjaftueshme para fillimit të punimeve, të informojë autoritetet përkatëse në mënyrë që mund të ndërmerren hapat e nevojshëm për të bërë të mundur spostimin e kablllove.

4.2 Skelera

Të gjitha skelat duhet të projektohen dhe të montohen në përputhje me standardet e kërkuara. Vetëm punëtorët me përvojë dhe kompetent do të montojnë skelerinë në lartësi. Kontraktuesi do të sigurojë që çdo modifikim të nevojshëm të skelave gjatë rrjedhës së punëve, do të pranohen nga montuesit e skelave në mënyrë që skela do të mbetet i përshtatshëm për qëllimin për të cilin janë të dedikuara. Nënshkrimi i miratimit të skelës do të bëhen i dukshëm në çdo pikë të hyrjes në nivel të tokës tek skela. Punimet në skelë të paautorizuara është rreptësisht e ndaluar. Duhet patur kujdes që ngarkesa e çdo grumbulli mbeturinash në skelë nuk e duhet ta kalojë ngarkesën e lejuar sipas projektimit. Ngarkesat maksimale të lejueshme të skelave do të jenë qartë të dukshme në të gjitha pikat e hyrjes në nivelin e

tokës. Duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar hedhjen aksidentalisht të mbeturinave nga platforma. Skela metalike e tipit mbështetës, në përputhje me standardet dhe rregullat lokale, duke përfshirë furnizimin e mbështetëses, mirëmbajtjen, montim, ankorimit, çmontimin etj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

15cm nga dyshemeja do të vendosen në të gjitha nivelet. Copë mbrojtëse ndaj motit ose të paktën rrjetë mbrojtëse duhet të vendoset në pjesën e jashtme të skelës.

5. TRANSPORTI DHE MAGAZINIMI I MATERIALEVE

Transporti i çdo materiali nga Kontraktori, do të bëhet me makina të përshtatëshme, të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar. Ndonjë makinë që nuk plotëson këtë kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantieri. Të gjitha materialet që sillen nga Kontraktori, duhet të stivohen ose të magazinohen në mënyrë të përshtatëshme për t'i mbrojtur nga rrëshqitjet, dëmtimet, thyerjet, vjedhjet dhe në dispozicion, për tu kontrolluar nga Mbikqyrësi i Punimeve në çdo kohë.

6. PASTRIMI PËRFUNDIMTAR I ZONËS

Në përfundim të punës, sa herë që është e aplikueshme Kontraktori duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi të gjitha impiantet ndërtimore, materialet që kanë tepruar, mbeturinat, skeleritë dhe ndërtimet e përkohëshme të çdo lloji dhe të lërë sheshin e lirë dhe veprat të pastra dhe në kondita të pranueshme.

7. PUNIME PRISHJEJE-ÇMONTIMI DHE PASTRIMI

7.1 Të përgjithshme

Punimet e prishjes dhe çmontimit në restaurim janë një proces i rëndësishëm, në të duhet të marrin pjesë punëtorë të specializuar të cilët duhet të mbikëqyren në çdo rast nga drejtuesi teknik i punimeve. Nëpërmjet prishjes evidentohen gjurmë të reja të cilat sjellin dëshmi të reja lidhur me monumentin të cilat duhet të dokumentohen. *Materialet e nxjerra nga çmontimi pas seleksionimit nëse nuk janë të dëmtuar ripërdoren.*

REFERENCAT: Publikimet e listuara më poshtë formojnë një pjesë të këtij specifikimi të referencave të zgjeruara. Botimet që janë të referuara në tekst janë të përcaktuara vetëm për gjërat bazë. m³

7.2 Ligjet dhe Normat e aplikuara shqiptare:

- Çdo ndërhyrje e propozuar duhet të jetë në përputhje me parimet e “Kartës Shqiptare të Restaurimit”, VKM. Nr.426, 13 Korrik 2007.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- Ligji Nr.9048, datë 04/07/2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”, (I ndryshuar) DORËZIMET :

Dorëzimet në vijim:

7.2.1 Deklarimet: Dorëzimi i procedurave të propozuara të prishjeve dhe heqjes së materialeve tek Mbikqyrësi për miratim, para se puna të fillojë. Procedura do të sigurojë heqjen e kujdesshme dhe sistemimin e materialeve në koordinim me veprat e tjera në proces, dhe një orar për mospengimin e shërbimeve komunale, të gjitha lejeve të nevojshme nga kompanitë e furnizimit e të shërbimeve. Një përshkrim të detajuar të metodave dhe pajisjeve që do të përdoren për çdo punë dhe të vazhdimin të punëve që kryhen.

7.2.3 Kushtet e mbikqyrjes: Në rastet kur prona fqinje mund të dëmtohet nga punimet atëherë Kontraktuesi duhet të kryejë me shpenzimet e tij një studim të detajuar të gjendjes së pronës fqinje përfshirë këtu edhe dokumentacionin fotografik një kopje e të cilit duhet të paraqitet dhe të miratuar nga Mbikqyrësi para fillimit të punimeve.

7.2.4 KËRKESAT: Puna përfshin çmontimin dhe largimin e të gjitha materialeve të diktura ose të specifikuara. Punimet e prishjeve nuk do të fillojnë deri sa autorizimi të merret nga Mbikqyrësi. Të gjitha materialet që rezultojnë nga prishja, përveç nëse tregohet apo të specifikohet ndryshe, do të largohen nga kufijtë e sheshit të ndërtimit. Mbeturinat do të hiqen nga kantieri çdo ditë, përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Mbikqyrësi; akumulimi i materialit të tillë është i ndaluar. Materialet të cilat nuk mund të hiqen brenda ditës do të ruhen në mënyrë të përshtatshme në zonat e përcaktuara. Nëse Kontraktuesi identifikon kalbësira në dru gjatë punimeve të çmontimit ai do të marrë masat e duhura për sigurinë e shëndetit. Njoftohet menjëherë Mbikqyrësi dhe i propozohen masa të përshtatshme për miratim. Kontraktuesi duhet të paraqesë prova për asgjësimin e duhur të materialeve me kërkesë të Mbikqyrësit.

7.3 Pastrimi i kantierit

7.3.1 Pastrimi i kantierit:

Në fillim të kontratës, për sa kohë që ajo nuk ka ndryshuar, kontraktori duhet të heqë nga territori i punimeve të gjitha materialet organike vegjetare dhe ndërtuese, dhe të djegë të gjitha pirgjet e mbeturinave të tjera.



7.3.2 Mbrojtja e objekteve, rrethimeve dhe strukturave:

Gjatë kryerjes të punimeve prishëse, kontraktuesi duhet të marrë masa që të mbrojë objektet dhe strukturat që gjenden në afërsi të objektit, ku po kryhen këto punime prishëse.

Për këtë, duhen evituar mbingarkesat nga të gjitha anët e strukturave nga grumbuj dhe materiale. Kur grumbujt dhe materialet duhen zbritur poshtë, duhet pasur kujdes që të parandalohet shpërndarja ose rënia e materialeve, ose të projektohet në mënyrë të tillë, që mos të përbëjë rrezik për njerëzit, strukturat rrethuese të çdo lloji.

Duhet bërë kujdes nga kontakti me kabllot elektrik.

7.3.3 Mbrojtja e vendit të pastruar:

Kontraktori duhet të ngrejë rrjetë të përshtatshme, barriera mbrojtëse, në mënyrë që, të parandalojë aksidentime të personave ose dëmtime të godinave rrethuese nga materialët që bien, si dhe të mbajë nën kontroll territorin, ku do të kryhen punimet.

7.4 PUNIME PRISHJEJE

7.4.1 Skeleritë:

Çdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përshtatje me KTZ dhe STASH. Një skelator kompetent dhe me eksperiencë, duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive që duhet të çdo tipi. Kontraktori duhet të sigurojë, që të gjitha rregullimet e nevojshme, që i janë kërkuar skelatorit të sigurojnë stabilitetin gjatë kryerjes së punës. Kujdes duhet treguar që ngarkesa e copërave të mbledhura mbi një skeleri, të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar. Duhet marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platforma e skelës. Skeleritë duhen të jenë gjatë kohës së

përdorimit të përshtatshme për qëllimin për të cilin do përdoren dhe duhet të jenë konform të gjitha kushteve teknike.

Në rastet e kryerjes së punimeve në anë të rrugës ku ka kalim si të kalimtarëve, ashtu edhe të makinave,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

duhet të merren masa që të bëhet një rrethim i objektit, si dhe veshja e të gjithë skelerisë me rrjete mbrojtëse për të eliminuar rënien e materialeve dhe duke përfshirë shenjat sinjalizuese sipas kushteve të sigurimit teknik.

Skeleri çeliku të tipit këmbalec, konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementët horizontalë duhet të kenë parmakë vertikalë, më lartësi min.15 cm si dhe mbrojtjen me rrjetë.

Skeleri çeliku në kornizë dhe e lidhur, konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementët horizontalë duhet të kenë parmakë vertikalë, me lartësi min.15 cm si dhe mbrojtjen me rrjetë.

7.4.2 Mbikqyrja

Kontraktori duhet të ngarkojë një person kompetent dhe me eksperiencë, të trajnuar në llojin e punës për ngritjen e skelerive dhe të mbikëqyrë punën për ngritjen e skelave në kantier.

7.4.3 Metoda e prishjes

Puna për prishje do të fillojë vetëm pasi të jenë stakuar energjia elektrike dhe rrjete të tjera të instalimeve ekzistuese të objekteve.

Metodat e prishjes së pjesshme, duhet të jenë të tilla që pjesa e strukturës që ka mbetur të sigurojë qëndrueshmërinë statike të objektit.

Kur prishja e elementeve të ndërtesës nuk mund të bëhet pa probleme e ndarë nga pjesa e strukturës do të përdoret një metodë pune e përshtatshme. Elementët e drurit mund të hidhen nga lart, vetëm kur ato nuk paraqesin rrezik për pjesën tjetër të stukturës. Kur prishen elementët, duhen marrë masa për

të mos rrezikuar elementët e tjerë konstruktive mbajtës, si dhe mos dëmtohen elementët e tjerë.

Në përgjithësi, puna e cmontimit duhet të fillojë duke hequr sa më shumë ngarkesa të panevojshme, *pa ndërhyrë në elementët bazë struktural*. Punë të kujdesshme do të bëhen për të hequr ngarkesat kryesore nën kushtet më të vështira. Seksionet të tjera që do të prishen do të ndahen dhe do të ulen në tokë nën



kontroll.

8 NËDËRHYRJE KONSERVUESE DHE RESTAURUESE

8.1 Të përgjithshme

Çdo ndërhyrje e propozuar duhet të jetë në përputhje me Projektin e miratuar në KKR si dhe parimet e “Kartës Shqiptare të Restaurimit”

8.2 Shpjegim i terminologjisë

“Konservim” janë të gjitha masat e ndërmarra që nuk kërkojnë ndërhyrje direkte në vepër siç janë krijimi i kushteve mjedisore (lagështi relative, temperaturë, pastërti nga ndotja atmosferike, mbrojtja nga pluhurat, dëmtimi biologjik dhe fizik në fonde, ekspozimi dhe transporti), si edhe ndërhyrjet kimike direkt në objekt apo vepër, me qëllim parandalimin e çdo lloj dëmtimi.

“Ndërhyrje” është tërësia e masave të ndërmarra dhe operacioneve të kryera në vepër, me qëllim ndalimin e degradimit të mëtejshëm dhe nxjerrjen në pah të vlerave të saj.

“Restaurimi” është vlerësimi i thelbit origjinal të monumentit nëpërmjet ndërhyrjeve për ndalimin e degradimeve të mëtejshme dhe nxjerrjen në pah të vlerave të tyre.

Këshillat mbi Parimet dhe Metodatat të cilat ofrojnë udhëzimet e propozuara të ndërhyrjeve restauruese duhet të lexohen së bashku me këtë dokument.

8.3 Ndërhyrjet në “monumentet e kulturës”

Në disa raste nevojat për konservim duhet ti paraprijnë atyre të vendosjes në siguri, në vazhdim nuk është e nevojshme të rregullohen nivelet e sigurisë të një ndërtese historike me ato ndërtesave të reja por është e mjaftueshme që nivelet e sigurisë të përmirësohen krahasuar me ato para ndërhyrjes.

Teknikat e ndërhyrjeve që do përdoren në monumentet e kulturës duhet të respektojnë karakteristikat

historike, artistike, arkitektonike dhe shpërndarjen e tyre. Kjo do të thotë që përmirësimi duhet të realizohet pa prodhuar modifikime substanciale në sjelljen e strukturës dhe

ndërtesës duke përdorur për sa është e mundur teknika ndërhyrje dhe metodologji operative



tradicionale, konservim të materies, kushteve fizike dhe morfologjike. Teknika dhe materiale me karakter reversibël edhe pjesor që përdoren në mënyrë diskrete, jo evazive dhe në koherencë me llogjikën konstruktive të strukturës ekzistuese.

9 PUNIMET QË DO TË KRYHEN:

1. Heqja e dherave dhe mbeturinave me karrocë dore

Në këtë zë përfshihet pastrimi i ambientit nga mbeturinat, dherat dhe mbetjet e tjera të punimeve. Ato do të grumbullohen në pjesën e jashtme të ambientit dhe më pas do të transportohen në një distancë të përshtatshme nga manastiri. Vendi i depozitimit do të përcaktohet nga autoritetet vendore.

2. Pastrimi nga bimësia dhe tharja e rrënjëve masive

Në këtë zë përfshihet pastrimi i zonës nga bimësia, prerja e pemëve të larta dhe tharja e rrënjëve me solucion të përshtatshëm.

3. Prishje murature guri

Në këtë zë përfshihet prishja e mureve që kanë humbur vertikalitetin, si dhe e atyre që kanë pësuar dëmtime të konsiderueshme ose hapje të mëdha. Përfshihet gjithashtu prishja e kolonave të deformuara.

4. Çmontim murature guri me pastrim

Në disa pjesë ka muraturë guri të mbuluar me mbeturina. Ky zë përfshin pastrimin, nxjerrjen dhe rimontimin e pjesëve të muraturës, si dhe sistemimin e gurëve të çmontuar për ripërdorim.

5. Hapje vrimash në muraturën e gurit

Ky zë do të kombinohet me zërin nr. 18. Në nivelin e ndërkatit, ku kanë qenë trarët ekzistues dhe ku ata kanë humbur funksionin për shkak të kalbëzimit, së bashku me brezat lidhës të muraturës do të vendoset një mbajtëse metalike me profil IPE 200. Kjo mbajtëse do të fiksohet përgjatë muraturës nga ana e brendshme dhe do të shërbejë për lidhjen e trarëve dhe ndërkateve. Në vrimat ekzistuese të trarëve do të vendosen tiranta hekuri, të cilat nga njëra anë do të saldohen me profilin metalik, ndërsa nga ana e jashtme do të fiksohen me dado F14 mm dhe pllakë metalike 10×150×150 mm. Trarët do të mbështeten në profilin metalik nga njëra anë dhe mbi muraturën e gurit nga ana tjetër.

6. Çmontimi i çatisë në portën e jashtme

Porta e jashtme, e cila ndodhet në krahun e konakut lindor, do t'i nënshtrohet punimeve restauruese. Fillimisht do të realizohet çmontimi i mbulesës me rase guri, duke u treguar kujdes për ruajtjen dhe sistemimin e materialit ekzistues me qëllim ripërdorimin e tij gjatë rindërtimit.



7. Muraturë guri me llaç gëlqereje deri në lartësi 3 m

Ky zë përfshin ndërtimin dhe plotësimin e muraturës prej guri në fasada dhe në pjesët e ndërkateve. Muratura do të realizohet në përputhje me tipologjinë ekzistuese të objektit. Për ndërtimin do të përdoren gurët ekzistues të ripërdorshëm, si dhe gurë plotësues të ngjashëm për nga forma, përmasat dhe karakteristikat petrografike. Lidhja e muraturës do të realizohet me llaç gëlqereje në raport 1:2. Brezat lidhës do të realizohen me dru pishe të stazhonuar.

8. Ndërtimi i kolonave katrore dhe rrethore

Ky zë përfshin rindërtimin e kolonave katrore dhe rrethore të vendosura në fasadat e brendshme të kompleksit. Punimet do të realizohen duke përdorur gurët ekzistues të rikuperuar dhe gurë plotësues me formë, përmasa dhe përpunim të ngjashëm me elementët origjinalë.

9. Ndërtimi dhe restaurimi i qemerëve

Në brendësi të harqeve ndodhen disa qemerë të dëmtuar, të cilët do të restaurohen dhe plotësohen me gurë të përpunuar sipas teknikës tradicionale të ndërtimit, duke ruajtur formën, dimensionet dhe karakterin origjinal të tyre.

10. Konsolidimi i muraturës me rreshta guri dhe llaç gëlqereje

Dy rreshtat e sipërm të muraturës përgjatë gjithë perimetrit të manastirit do të konsolidohen dhe nivelohen me llaç gëlqereje në raport 1:2, me qëllim krijimin e një baze të qëndrueshme për vendosjen e kapakëve mbrojtës.

11. Konsolidimi i kreut të muraturës me pllaka guri

Kreu i muraturës do të mbrohet me kapakë guri me trashësi 4–5 cm, të vendosur me dalje rreth 8 cm nga faqja e jashtme e murit, për të siguruar largimin e ujërave atmosferike dhe mbrojtjen e muraturës.

12. Restaurimi i brezave prej lisi të stazhonuar

Në zonat ku është e mundur, brezat ekzistues të degraduar do të zëvendësohen me elementë të rinj prej lisi të stazhonuar, duke respektuar sistemin konstruktiv tradicional dhe pa dëmtuar muraturën historike.

13. Breza druri për konsolidimin e kreut të muraturës në çati

Konstruksioni i çatisë do të mbështetet mbi breza druri pishe të stazhonuar, të vendosur në kreun e muraturës dhe të lidhur transversal sipas trashësisë së murit. Seksioni i tyre do të jetë 7×15 cm ose sipas përcaktimeve të projektit konstruktiv.

14. Restaurimi i fasadës me teknikën “shqep-qep”

Në pjesët e dëmtuara të fasadës kryesore do të zbatohet teknika tradicionale “shqep-qep”, me qëllim ruajtjen e autenticitetit të muraturës. Kjo ndërhyrje do të përqendrohet veçanërisht në zonën



qendrore, ku evidentohet një dritare e dëmtuar.

15. Ulluge shkarkimi vertikale dhe horizontale prej llamarine të zinkuar

Ky zë përfshin furnizimin dhe vendosjen e sistemit të ullugeve horizontale dhe vertikale për grumbullimin dhe largimin e ujërave atmosferike. Mbjtëset e ullugeve do të vendosen përpara realizimit të mbulesës me rase guri.

16. Çati e mbuluar me rase guri (porta e hyrjes)

Porta e hyrjes, e vendosur pranë konakëve, është e ndërtuar me gur dhe e mbuluar me rase guri. Pasi zbulohet nga rasa e gurit, rasat sistemohen. Traret e drurit do të nderrohen, ato të cilat janë kalbur dhe thyer me trare pishe kende të stazhionuar. Catia do të jete po e njejta me atë ekzistuesen

17. Cati Hd : 10 m e mbuluar me rase guri

Catia e mbulimit të konakeve do të jete cati me rase guri. Konstruksioni mbajtës do të realizohet me dru pishe të stazhionuar, duke përfshirë trarët, mahitë dhe petavrat. Trashësia e petavrave nuk do të jetë më e vogël se 2.5 cm. Për mbrojtjen nga lagështia do të shqyrtohet mundësia e vendosjes së një shtrese hidroizoluese të përshtatshme

18. Ndërtimi i tavanit dekorativ prej dërrase pishe

Tavani do të realizohet me dërrasa pishe të stazhionuara. Motivet dekorative do të përcaktohen në bashkëpunim me projektuesin, mbikëqyrësin e punimeve dhe përfaqësuesit e komunitetit, duke respektuar karakterin e objektit.

19. Furnizimi dhe vendosja e trarëve prej pishe të stazhionuar 15 × 15 cm

Trarët e ndërkatit do të realizohen me dru pishe të stazhionuar me seksion 15 × 15 cm. Ata do të lidhen me sistemin mbajtës metalik dhe me muraturën sipas zgjidhjes konstruktive të projektit.

20. DysHEME druri

DysHEMEJA do të realizohet me dërrasa pishe të stazhionuara me trashësi jo më të vogël se 3 cm. Dërrasat do të vendosen me sistem bashkimi mashkull-femër (petavra), duke siguruar qëndrueshmëri dhe vazhdimësi të sipërfaqes.

21. Ndërtimi i shkallëve prej druri

Ky zë përfshin realizimin e shkallëve prej druri që sigurojnë komunikimin ndërmjet kateve dhe aksesin nga hyrja kryesore në katin e parë.

22. Shtresë me pllaka guri të skuadruara

Në katin përdhe do të realizohet shtresë me pllaka guri të skuadruara me trashësi 4–5 cm. Pas zbulimit të shtresës ekzistuese do të vlerësohet gjendja e saj dhe mënyra e shtrimit të pllakave të reja.



23. Pragje me rase guri

Pragjet e dritareve do të realizohen me pllaka guri të skuadruara dhe të punuara me çukitje tradicionale, në përputhje me karakterin arkitektonik të objektit.

24. Suvatim i brendshëm me llaç gëlqereje 1:2

Sipërfaqet e brendshme të katit të parë do të suvatohet me llaç gëlqereje në raport 1:2. Procesi do të përfshijë sprucimin, mbushjen, rafshimin dhe aplikimin e shtresës përfundimtare. Punimet do të koordinohen me instalimet elektrike, të cilat do të realizohen sipas nevojave funksionale të objektit.

25. Suvatim i fasadës me llaç gëlqereje

Ky zë përfshin restaurimin dhe plotësimin e suvasë ekzistuese në fasadë me llaç gëlqereje. Ndërhjyrtet do të përcaktohen pas verifikimit në terren dhe në konsultim me projektuesin, mbikëqyrësin dhe përfaqësuesit e komunitetit.

26. Furnizim dhe vendosje dritaresh druri kasë binarë me xham tek

Dritaret do të realizohen me dru pishe të stazhonuar të cilësisë së parë, të pajisura me elementë metalikë funksionalë. Forma dhe detajet e tyre do të respektojnë tipologjinë tradicionale të objektit. Dritaret do të përbëhen nga dy kanate të ndara në kuadrate më të vogla me xham tek.

27. Furnizim dhe vendosje dyersh druri, cilësia e parë

Dyert e brendshme do të realizohen me dru pishe të stazhonuar të cilësisë së parë. Forma, përmasat dhe detajet dekorative do të përcaktohen nga projektuesi në konsultim me përfaqësuesit e komunitetit dhe specialistët e restaurimit.

28. Furnizim dhe vendosje dërrës të jashtme prej druri masiv

Ky zë përfshin realizimin e dërrës të hyrjes në manastir dhe në konak. Dyert do të prodhohen prej druri masiv me trashësi rreth 5 cm dhe do të projektohen në përputhje me karakterin historik të objektit.

29. Sherbetim me gëlqere

Të gjitha sipërfaqet e suvatuara do të lyhen me gëlqere të stazhonuar. Lyerja do të realizohet në disa shtresa, deri në arritjen e një mbulimi uniform të sipërfaqeve.

30. Pastrimi i fasadës nga pluhuri dhe depozitimet sipërfaqësore me ujë me pompe me presion.

Ky zë përfshin pastrimin e fasadës nga pluhuri, papastërtitë dhe depozitimet sipërfaqësore me ujë nën presion të kontrolluar, duke shmangur dëmtimin e materialeve historike dhe të elementeve dekorative.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Punoi:

Ing. Ardis DUKA

Ing. Vasil POLO

Ing. Manxhina BRAHIMI